



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. 1136 Prot.  
Datë 23.02.2026



BASHKIA  
LIBRAZHDI

Nr. 995 Prot.  
Datë 17.02.2026

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*NDËRMJET*

MINISTRISË SË DREJTËSISË

*DHE*

BASHKISË LIBRAZHDI

*« Për koordinimin ndërinstitucional në funksion të mbrojtjes së viktimave të krimit dhe garantimit të ndihmës juridike falas. »*

Sot, më datë \_\_\_\_\_ lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

**Ministrisë së Drejtësisë**, me adresë: Bulevardi “Zogu i Parë”, Tiranë, përfaqësuar nga Zëvendës Ministri e Drejtësisë, znj. Elona Hoxha, këtu e në vijim « **Ministria** ».

*Dhe*

**Bashkisë Librazhd**, me adresë: Sheshi “Gjorg Golemi”, Librazhd, përfaqësuar nga Z/Zj. \_\_\_\_\_, këtu e në vijim « **Bashkia** ».

Duke qenë se Palët,

**Vlerësojnë** rëndësinë e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në kuadër të rritjes së aksesit në drejtësi për qytetarët si një parim themelor kushtetues.

**Konsiderojnë** se një ndër elementët kyç të aksesit në drejtësi është sigurimi i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike të garantuara nga shteti në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

**Marrin në konsideratë** politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

**Synojnë implementimin efektiv të ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe zbatimin e objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi, mbrojtjen, trajtimin me dinjitet dhe fuqizimin e viktimave të krimit, bazuar në parimet e:**

- a) aksesit të barabartë dhe efektiv të individëve në ndihmën juridike;
- b) barazisë, mosdiskriminimit dhe trajtimit të drejtë të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike;
- c) garantimit të mbrojtjes, sigurisë, konfidencialitetit dhe integritetit personal të viktimave të krimit;
- d) ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
- dh) shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit;
- e) mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël, në veçanti të viktimave të krimit, duke siguruar një qasje të koordinuar dhe të integruar ndërinstucionale.

**Konfirmojnë**, angazhimin institucional për të siguruar standarte të larta dhe për të adresuar nevojat e subjekteve përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017.

**Afirmojnë** vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje.

---

Adr: Rr. “Jordan Misja”, Godina nr. 3, Njësia bashkiake nr. 9, Tiranë      Email: dnjf@drejtesia.gov.al

*Kanë rënë dakord* të lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi në vijim e quajtur *Marrëveshje*.

## Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është vendosja e bashkëpunimit ndërmjet Palëve për garantimin e ndihmës juridike shtetërore dhe rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve, veçanërisht të grupeve vulnerabël dhe viktimave të krimit. Palët angazhohen të sigurojnë një proces të koordinuar në trajtimin e rasteve përmes ndërveprimit të rregullt mes Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Bashkisë Librazhd.

## Neni 2 Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në *nenin 2; nenin 4; nenin 8* të ligjit nr. 111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*” si dhe në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “*Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë*”.

## Neni 3 Qëllimi

Palët bien dakord të bashkëpunojnë mbi:

- Promovimin e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta sensibilizuese; edukimit ligjor apo afishimit të materialeve të vizibilitetit;
- Shkëmbimin e përvojës në kuadër të përmirësimit të politikave shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
- Zhvillimin e takimeve për të diskutuar çështjet me interes të përbashkët;
- Planifikimin dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta në këtë kuadër;
- Kryerjen e analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim nxjerrjen e rekomandimeve të karakterit ligjor dhe administrativ dhe vënien e tyre në dispozicion të palëve, të cilat do të vlerësojnë nevojën dhe formën e ndërhyrjeve konkrete bazuar në kompetencat ligjore.
- Referim i rasteve për të përfituar ndihmë juridike parësore falas.
- Zhvillimin e sesioneve informuese në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030.
- Referimin e rasteve të viktimave të krimit për të përfituar ndihmë juridike falas.

## Neni 4

## Personat e kontaktit

Secila nga palët cakton një person kontakti të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura në letër.

Në çastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje personat e kontaktit janë si vijon:

### **Për Ministrinë e Drejtësisë**

Emër/Mbiemër: Znj. Patricia Pogaçe

Email: [Patricia.Pogace@drejtesia.gov.al](mailto:Patricia.Pogace@drejtesia.gov.al)

Nr. Cel: 0682583445

### **Për Bashkinë Librazhd:**

Emër/Mbiemër Z. Mariglen Disha

E-mail: \_\_\_\_\_

Nr. cel: \_\_\_\_\_

Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) jave kalendarike nga data e ndryshimit, mbi të dhënat e personit të ri të kontaktit.

Neni 5

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 6

### **Dispozita të fundit**

Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet palëve.

Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeve pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje mirëkuptimi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PËR MINISTRINË E DREJTËSISË

Zëvendës Ministre e Drejtësisë  
Znj. Elona Hoxha



PËR BASHKINË  
LIBRAZHID

Kryetari i Bashkisë  
Z. Mariglen Disha

